

28
Consumer & health
protection

KAPITULLI 28

Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik

Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik përmban dy fusha:

- a) Mbrojtjen e konsumatorit; dhe
- b) Mbrojtjen e shëndetit publik.

Mbrojtja e konsumatorit ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të interesave ekonomike të konsumatorit nga mallrat dhe shërbimet në treg. Disa nga aspektet kryesore të tij janë:

- Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave ekonomike të konsumatorëve-të drejtës për trajtim të barabartë, informim të saktë, kompensim, mbrojtje nga reklamime keqinformuese-përmban rregullat për informimin dhe edukimin e konsumatorit dhe mekanizmat për zgjidhjen e shkeljeve të të drejtave të konsumatorëve. Këtu mbulohen ndër të tjera rregullat për produktet defekte, reklamat keqinformuese, kreditë konsumatorë, shitjet në shtëpi, shitjet në distancë, etj. legjislacioni ofron mbrojtje të veçantë për konsumatorët e pambrojtur.
- Kuadri ligjor për sigurinë e produkteve, që garanton që produktet e hedhura në treg përputhen me kërkesat e përgjithshme të sigurisë dhe legjislacion teknik përkatës që të mos rrezikojnë shëndetin e konsumatorëve. Ai përmban ndër të tjera rregulla për prodhimin, etiketimin, reklamimin dhe shitjen e këtyre mallrave.

Politika për mbrojtjen e shëndetit publik kanë qëllim përmirësimin dhe mbikqyrjen e shëndetit të përgjithshëm publik. Ajo përfshin masa për luftimin e sëmundjeve të transmetueshme, trajtimin e sëmundjeve të rralla dhe kancerit, luftimin e varësive nga duhani, alkooli dhe droga dhe dëmet e tyre, parandalimin e dëmeve në shëndet nga ndotja e mjedisit përfshi fushat elektro-magnetike, nxitjen e e të ushqyerit të shëndetshëm, mbrojtjen e shëndetit mendor, kërkesat për sigurinë dhe cilësinë e transfuzionit të gjakut dhe transplantit të qelizave, indeve dhe organeve, prodhimin e barnave dhe pajisjeve mjeksore, produktet kozmentike, etj.

Në kuadër të negociatave, Shqipëria duhet të adoptojë standardet e BE-së për politikat e shëndetit publik, përfshi parandalimin e sëmundjeve, programet e vaksinimit dhe fushatat e informimit shëndetësor.

Grupet me interes për t'u përfshirë:

Shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve; shoqatat e tregtarëve përfshirë tregtinë online, shoqatat e profesionistëve të mjekësisë; urdhërat e mjekut, infermierit dhe farmacistit; shoqatat e prodhuesve dhe distributorëve të produkteve mjekësore; dhomat e tregtisë dhe industrisë.

Institucioni udhëheqës i negociatave:

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Institucione kyçe të përfshira në negociatë:

- Ministria e Financave
- Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
- Instituti i Shëndetit Publik
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
- Qendra Kombëtare për Kontrollin e Gjakut